

3. Grante për fermerët e vegjël

Pas përfundimit të trajnimeve profesionale, kandidatët që plotësojnë kriteret (ose gjithsej 74 kandidatë) nga sektori i frutave, perimeve dhe blegotrisë do të mbështeten me grante për zhvillimin e sektorit të tyre.

Vlera mesatare e grantit (në të mira) për një përfitues do të jetë 3,000€, përfituesi/ja do të bashkëfinancojë (10%+tvsh) nga kostoja totale.

Kur do të fillojë aplikimi për grante?

Gjatë viteve 2020/2022 në fillim të muajit mars do të vendosen shpalljet nëpër komuna dhe përmes Web faqes së IADK-së dhe në Facebook do të shpërndahen informacionet për kohën dhe vendin e aplikimit për grante dhe do të organizohen sesione informuese.

Ku mbahen sesionet informuese?

IADK do të promovojë projektin nëpërmjet seancave informuese që do të mbahen në komunat ku do të zbatohet projekti.

Ku duhet të aplikohet për grante?

Kandidatët e interesuar për aplikim do të mund t'i marrin aplikacionet në departamentet komunale për bujqësi në komunat ku ka shtrirje projekti, apo edhe direkt në zyrat e IADK-së, dhe pas plotësimit të dokumentacionit të kërkuar me aplikacion dorëzohen në departamentin komunal për bujqësi apo në IADK.

Si bëhet përzgjedhja e përfituesve?

Pas pranimit të aplikacioneve nga pika 2 dhe 3 një komision i përbashkët i ekspertëve të IADK-së dhe komunës përkatëse nga janë aplikuesit, do të del në teren për të bërë përzgjedhjen e përfituesve në bazë të kriterëve të poentimit.



INITIATIVE FOR AGRICULTURAL DEVELOPMENT OF KOSOVO
INICIATIVA PËR ZHVILLIMIN E BUJQËSISË SË KOSOVËS
INICIATIVA ZA POLJOPRIVREDNI RAZVOJ KOSOVA



INITIATIVE FOR AGRICULTURAL DEVELOPMENT OF KOSOVO
INICIATIVA PËR ZHVILLIMIN E BUJQËSISË SË KOSOVËS
INICIATIVA ZA POLJOPRIVREDNI RAZVOJ KOSOVA

Për informata :

IADK

Adresa:

Fshati: Sfaraçak i Ulët, nr.11,


42000 Vushtrri,

Kosovë

Tel: +383(0) 44 777 036
+383(0) 49 777 046

E-mail: info@iadc.org

Web faqe: www.iadc.org



"Përmirësimi i punësimit dhe mundësive për gjenerim të të ardhurave në zonat rurale të Kosovës"



13/12/2019

Përkrahur nga:

Brot
für die Welt

Bread for the World -
Protestant
Development Service

Informata lidhje me projektin

Qëllimi i projektit është që përmes aktiviteteve përkrahëse për fermerë, të rinjët, gratë në zonat rurale, studentët e profilit të bujqësisë dhe teknologjisë ushqimore të krijoj kushte për aktivitete bujqësore apo biznesore, të cilat mundësojnë krijimin e të hyrave dhe përmirsojnë gjendjen socio-ekonomike të popullatës, sidomos në zonat rurale të Kosovës, ku do të ketë shtrirje projekti.

Projekti është dizajnuar për periudhën trivjeçare 2020-2022, dhe do të zbatohet në komunat: Vushtri, Skenderaj, Lipjan, Shtime, Viti dhe Kamenicë.

Objektivat e projektit:

- Gjenerimi i të ardhurave dhe promovimi i vendeve të punës në sektorin e bujqësisë.
- Trajnime profesionale në sektorin e bujqësisë.
- Fuqizimi i gruas në zonat rurale.

Projekti do të mbështesë përfituesit drejtpërdrejtë nëpërmjet granteve dhe aftësimi profesional, punës praktike, vizita studimore brenda Kosovës, trajnimeve për marketing, këshillave direkte dhe monitorimeve.

Grupet e synuara të projektit:

- Të rinjët;
- Gratë në zonat rurale;
- Minoritetet;
- Grupet e marginalizuara;

Në këtë fletpalosje janë përshkruar disa nga aktivitetet kryesore të identifikuar për grupet e synuar të projektit, për gjatë tri viteve 2020-2022.

Kush do të jenë përfituesit e projektit?

Praktikë për të rinjët dhe studentët

45 të rinjë/studentë të drejtimit të bujqësisë (përfshirë teknologjinë ushqimore) do të përfitojnë praktikë 3 mujore, projekti përfshin mbulimin e disa shpenzimeve siç janë: ushqimi, komunikim dhe shpenzime të transportit si dhe trajnime 5 ditore në shkathtësit e buta.

Gjatë 3 viteve të projektit do të përkrahen nga 15 studentë të cilët kanë diplomuar viteve të fundit apo që janë në përfundim të studimeve të tyre.

Trajnime bujqësore për të rinjët

Trajnime bujqësore për 60 të rinjë ku do të përfshihen temat rreth planit të biznesit, menaxhimit të fermave dhe teknikave të prodhimit. Pas përfundimit të trajnimeve të rinjët janë të ftuar të përgatisin një plan të detajuar të biznesit i cili synon të hapë një biznes fillestar në fushën e bujqësisë. Ata që ofrojnë biznesin planin më të mirë mbështeten me grante (shiko pikën 1).

1. Grante për të rinjët

Të rinjët do të paraqesin idetë inovative për të aplikuar në mundësin e grantit që si qëllim përfundimtar ka punësimin dhe gjenerimin e të ardhurave.

Nga 60 të trajnuar projekti do t'i japë mundësinë e përfitimit për grante 50 prej tyre që plotësojnë kriteret e përcaktuar nga organizata.

Vlera mesatare e grantit (në të mira) për një përfitues do të jetë 3,000€, përfituesi/ja do të bashkëfinancojë (10%+tvsh) nga kostoja totale, ndërsa idetë për investime do të përcaktohen nga aplikuesi gjatë hartimit të biznes planit të tyre.

Aftësim profesional për gratë

75 gra do të përfitojnë trajnime profesionale në sektorin e përpunimit të frutave, perimeve, qumështit, ëmbëlsirave ose brumërave.

Numri i përgjithshëm i grave do të ndahet në 5 (grupe), secili grup do të përbëhet nga 15 antarë. Pas përfundimit të trajnimeve kandidatet janë të ftuara që të aplikojnë për skemën e granteve për krijimin e njësive përpunuese (shiko pikën 2).

2. Grante për gratë

Kandidatët më të suksesshëm të selektuar për mbështetje do të kenë mundësi dhe qasje në grant rreth 12,000 euro, në total pesë (5) njësi përpunuese do të funksionalizohen dhe 15 gra do të punësohen. Përfituesja do të bashkëfinancojë (10%+tvsh) nga kostoja totale.

Aftësim profesional për fermerët ekzistues që merren me fruta dhe perime

Trajnime teorike dhe praktike për 90 fermerët ekzistues që merren me fruta, perime. Numri i përgjithshëm i fermereve do të ndahet në 6 (grupe) ku secili grup do të përbëhet nga 15 antarë dhe do të ndjekin trajnime 7 ditore. Pas përfundimit të trajnimeve kandidatët janë të ftuar të aplikojnë në skemën e granteve (shiko pikën 3).

Aftësim profesional për sektorin e blegtorisë

Trajnime teorike dhe praktike për 30 kandidatë. Numri i përgjithshëm do të ndahet në dy grupe nga 15 antarë dhe secili grup do të ndjek 30 ditë trajnime dhe pas përfundimit të tyre do të pajisen me certifikatë të validuar nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK) si dhe do të kenë mundësinë për aplikim në skemën e granteve (shiko pikën 3).